



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

implemented by:
**inter
cooperation**

Natural Resource Management
Rural Economy
Local Governance and Civil Society

Swiss – Kosovo

Local Governance and Decentralization Support

LOGOS



Prezentim i buxhetit komunal për vitin 2011

Komuna e SHTËRPCËS

LOGOS



Ky prezentim është përgaditur nga RECURA Financials
për projektin LOGOS të implementuar nga Intercooperation

Maj 2011

RECURA Financials

Address: Nëna Terezë 28/1, 10000 Prishtina, Kosovo

tel: +381 (0)38 777 800, Fax: +381 (0) 38 22 14 14 ; cel: +386(0)49 160 049; 777 800

info@recura.biz - www.recura.biz

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL	4
ZYRA E KRYETARIT	7
ASAMBLEJA KOMUNALE.....	7
ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL.....	9
SHËRBIMET PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA	9
KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI.....	11
SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE.....	13
ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI	13
INVESTIMET KAPITALE	15

HYRJE

Ky dokument është një përmbledhje e buxhetit komunal për vitin 2011, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky dokument nuk është dokument zyrtar komunal dhe paraqet një përmbledhje të buxhetit të përgaditur nga projekti LOGOS me qëllim të informimit sa më të mirë dhe përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në procesin buxhetor në komunë.

Dokumenti përmban një kategorizim të buxhetit sipas drejtorive dhe kategorive të shpenzimeve si dhe listën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara nga komuna për vitin 2011.

PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL

Shtërpçë - 655	
PASQYRE E PERGJITHSHME E BUXHETIT	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	2,908,097.45
INVESTIMET KAPITALE	647,698.45
PAGAT DHE MEDITJET	1,871,386.00
Pagat - Administrata Komunale	402,985.00
Pagat Arsimi	832,780.00
Pagat Shendetesia	635,621.00
MALLRA DHE SHERBIME	327,257.00
Administrata Komunale	83,692.00
Arsimi	54,960.00
Shendetesia	188,605.00
SHERBIMET KOMUNALE	51,442.00
Administrata Komunale	15,120.00
Arsimi	8,016.00
Shendetesia	28,306.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	10,314.00
Administrata Komunale	3,000.00
Arsimi	4,000.00
Shendetesia	3,314.00



Për vitin 2011, komuna e Shtërpçës është planifikuar të ketë në dispozicion 2,908,097.45 Euro, nga të cilat Qeveria ka ndarë 2,839,062 Euro, ndërsa komuna planifikon të realizojë të hyra vetanake në vlerë prej 69,035 Euro.

Siç mund të shihet nga tabela përmbljedhëse, nga ky buxhet, 647,698.45 Euro janë ndarë për projekte të investimeve kapitale në komunën e Shtërpçës.

Pagat dhe mëditjet e planifikuara kapin vlerën prej 1,871,386 Euro, nga të cilat shpenuesi më i madh është sektori i arsimit me 832,780 Euro, derisa administrata komunale ka të buxhetuara 402,985 Euro ndërsa shëndetësia 635,621 Euro për paga. Pagat janë të llogaritura në vlerë bruto përfshi edhe të gjitha tatimet dhe kontributet.

Shpenuesi i tretë buxhetor për nga madhësia është kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ku për komunën e Shtërpçës janë planifikuar 327,257 Euro, ku shpenzuesit më të mëdhenj janë administrata dhe sektori i arsimit.

Shërbimet komunale kapin vlerën prej 51,442 Euro, nga të cilat mbi 55% janë të dedikuara për sistemin shëndetësor.

Subvencionet dhe transferet janë në nivel prej 10,314 Euro, nga të cilat arsimit paraqet shpenzuesin më të madh të buxhetuar.



ZYRA E KRYETARIT

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
ZYRA E KRYETARIT	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	87,385.00
PAGAT DHE MEDITJET	67,735.00
Numri i stafit	12
MALLRA DHE SHERBIME	16,650.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	3,000.00

Nga zyra e Kryetarit të Komunës paraqiten shifrat prej rreth 67,735 Euro, të cilat shfrytëzohen për të paguar stafin dhe mëditjet e Zyres, që në vitin 2011 planifikohet të jenë gjithsej 12 vetë, me një pagë mesatare mujore (përfshi mëditjet) prej 470.38 Euro. Zyra e kryetarit ka të buxhetuara 16,650 Euro për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe 3,000 Euro për subvencione dhe transfere.

ASAMBLEJA KOMUNALE

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
ASAMBLEJA KOMUNALE	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	69,936.00
PAGAT DHE MEDITJET	64,303.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	
MALLRA DHE SHERBIME	5,633.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Asambleja e Komunës së Shtërpcës poashtu ka një shpenzim shumë të koncentruar dhe ate shumicën ne paga dhe mëditje për asambleistët në vlerë prej 64,303 Euro. Pjesa e mbetur prej 5,633 Euro është e paraparë për mallra dhe shërbime.



ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
ADMINISTRATA (Administrata dhe Personeli, Buxheti dhe Financat, Zyra e komuniteteve)	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	245,295.00
PAGAT DHE MEDITJET	193,622.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	56
MALLRA DHE SHERBIME	37,053.00
SHERBIMET KOMUNALE	14,620.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Në këtë linjë buxhetore janë të përfshirë drejtoritë e administratës dhe personelit, buxhetit dhe financave, Zhvillimit Ekonomik si dhe zyra e komuniteteve, me gjithësej 56 të punësuar. Buxheti total për shpenzimet e administratës komunale është 245,295 Euro, nga të cilat 193,622 Euro janë të dedikuara për paga dhe mëditje, me një pagë mesatare mujore prej 288.2 Eurosh. Mallrat dhe shërbimet janë të llogaritura në vlerë prej 37,053 Eurosh, ndërsa shërbimet komunale kapin vlerën prej 14,620 Euro.

SHËRBIMET PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	48,186.00
PAGAT DHE MEDITJET	28,962.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	7
MALLRA DHE SHERBIME	18,724.00
SHERBIMET KOMUNALE	500.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Shërbimet e përgjithshme publike dhe emergjencat kanë një buxhet prej 48,186 Eurosh, prej të cilave një pjesë e madhe është e dedikuar për paga dhe mëditje, 28,962 Euro. Me një staf prej 7 vetësh, paga mesatare mujore për këtë drejtori është 344.78 Euro. Për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për këtë drejtori janë ndarë 18,724 Euro, derisa për shërbimet komunale 500 Euro.



KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	53,995.00
PAGAT DHE MEDITJET	48,363.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	12
MALLRA DHE SHERBIME	5,632.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Drejtorja e Kadastrës si dhe ajo e Planifikimit urban dhe e mjedisit punëson një staf prej 12 vetësh me pagë mesatare prej 355.8 Euro dhe me një buxhet total vjetor prej 53,995 Euro.



SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE


KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
Shendetesia dhe Mireqenia Sociale	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	904,572.55
PAGAT DHE MEDITJET	635,621.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	155
MALLRA DHE SHERBIME	188,605.00
SHERBIMET KOMUNALE	28,306.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	3,314.00
SHPENZIMET KAPITALE	48,726.55

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale është njëra nga dy kategoritë specifike buxhetore, të cilat marrin grant (buxhet) të posaçshëm nga qeveria dhe poashtu është një nga drejtoritë me buxhet më të lartë. Për vitin 2011 për shëndetësi dhe mirëqenie social janë ndarë 904,572.55 Euro. Nga këto 635,621 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për punëtorët e këtij sektori (155 sish), të cilët marrin një pagë mesatare prej 341.73 Euro për muaj. Edhe kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime është e lartë pasi ka shpenime direkte në mallra dhe për vitin 2011 kap vlerën prej 188,605 Euro. Shërbimet komunale dhe subvencionet dhe transferet kapin vlerën prej 31,620 Euro. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale poashtu kanë një karakteristikë se investimet kapitale janë kategori e veçantë këtu, ku për vitin 2011 janë ndarë 80,000 Euro për investime direkte kapitale në këtë sektor.

ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI

KOMUNA:	TOTAL
Shtërpcë - 655	
Arsimi dhe kultura	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	915,516.00
PAGAT DHE MEDITJET	832,780.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	272
MALLRA DHE SHERBIME	54,960.00
SHERBIMET KOMUNALE	8,016.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	4,000.00
SHPENZIMET KAPITALE	15,760.00

Sektori i arsimit është shpenzuesi më i madh buxhetor në komunën e Shtërpcës me një buxhet të planifikuar prej 915,516 Eurosh. Nga këto, 832,780 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për 272 punëtorët e arsimit, me një pagë mesatare mujore prej 255.12 Euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë buxhetuar me 54,960 Euro, ndërsa shërbimet komunale me Euro dhe subvencionet e transferet me 13,322 Euro. Shpenimet kapitale të parapara për këtë sektor në vitin 2011 kapin vlerën prej 15,760 Euro.



INVESTIMET KAPITALE

Këtu përfshihen të gjitha investimet kapitale të planifikuara nga komuna e Shtërpcën , me përjashtim të investimeve kapitale në shëndetësi dhe arsim, të cilat janë të llogaritura në kuadër të këtyre dy sektorëve. Totali i planifikuar i investimeve kapitale (me përjashtim të shëndetësisë dhe arsimit) për vitin 2011 është 647,698 Euro, të planifikuara për realizimin e 13 projekteve në kuadër të komunës, të paraqitura në tabelën më poshtë.

Është me rëndësi të theksohet se projektet kapitale, sikurse i gjithë buxheti, i nënshtrohen një rishikimi në gjysmë të vitit dhe mund të pësojnë ndryshime. Ky proces i revidimit është shumë i rëndësishëm dhe pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e rëndësishme.

	KOMUNA:	TOTAL
	Shtërpcë - 655	
	Viti 2011	
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE (PA ARSIMIN DHE SHENDETESINE)	583,211.90
1	Renovimi I ndërtesës komunale	40,000
2	Participimi në projekte bashkfinancuese dhe intervenime emergjente	30,000
3	Përpilimi I projekteve detale	50,000
4	Blerja e veturave	40,000
5	Ndërtimi I kanalizimit, Brod-Gjonaj	10,000
6	Asfaltimi I rrugës Brod -Coklar, faza III	40,000
7	Asfaltimi I rrugës Izhanc, faza II	40,000
8	Rregullimi I kanalizimit, Brod-Rudaj	12,066
9	Nd. I murit dhe riparimi I urës, B. e Epërme	20,000
10	Ndërtimi I murit mbrojtës, Viqë	15,000
11	Ndërtimi I kanalizimit, Biti e Poshtme	10,000
12	Riparimi I rrugës, Godrovicë	10,505
13	Asfaltimi I rrugëve lokale, Shtërpcë	265,641



Nazim Gafurri str. 33
Po Box no.2
10000 Pristina, Kosovo
<http://www.intercoopkos.org/logos>

Tel: +381(0) 38 51 77 15
Tel: +381(0) 38 51 66 44
Fax: +381(0) 38 51 88 33
info@intercoopkos.org